

Kosova ende larg liberalizimit të vizave me vendet e BE-së

Jashtë procesit

Përfshirja e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave është me interes për Bashkimin Evropian, pasi me këtë parandalohet migrimi ilegal. Por, mosnjohja nga pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian e lë Kosovën jashtë këtij procesi dhe i stimulon kosovarët të pajisen me pasaporta serbe. Arsyeja tjetër, mbase më e rëndësishme, është plotësimi i kriterëve që paraprkishtë kërkohen nga Qeveria e Kosovës

NEXHMIJE AHMETI

Prishtinë, 22 qershor - Duhet të gjendet një rrugë që Kosova të mos përjashtohet nga procesi i liberalizimit të vizave, proces ky nga i cili pritet të përfitojnë disa vende fqinje. Kështu u tha të hënën në Prishtinë, në debatin rreth përfshirjes së Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave, i mbështetur nga "Robert Bosch Stiftung" dhe nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet. Pjesëmarrësit pohuan se Komisioni Evropian e ka parasysh këtë çështje dhe, me dyer të mbyllura, do të gjendet një "masë" për të filluar lehtësimi i vizave edhe për shtetasit e Republikës së Kosovës.

Verena Knaus, analiste e Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI), tha se Kosovës duhet t'i ofrohet një rrugë e qartë e këtij procesi, në mënyrë që edhe qytetarët të mos stimulohen të marrin pasaporta të Serbisë, shtet ky që pritet të përfshihet në liberalizimin e vizave. Sipas saj, bisedimet për liberalizimin e vizave me këtë shtet (Serbi) kanë filluar që në fillim të vitit 2008, si një lloj "stimulimi" në kohën kur pritej



pavarësimi i Kosovës. Po ashtu, edhe Maqedonia dhe Mali i Zi pritet të jenë ndër vendet që do të përfshihen në këtë proces, ndërkaq Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina do të mbesin jashtë përfshirjes së procesit për liberalizimin e vizave. Knausi tha se Ballkanit, duke aluduar më shumë në vendet që do të mbesin jashtë procesit të lehtësimi të vizave, i thuhet se ka perspektivë evropiane, ndërkaq, në anën tjetër,

vështirësohet qarkullimi i qytetarëve të këtyre vendeve. "Liberalizimi i vizave për rajonin, duke përfshirë edhe Kosovën, do të ishte edhe në interes të BE-së për shkak të sigurisë dhe kontrollit të migrimit joligjor". Sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën, për shkak të mosnjohjes nga pesë vendet anëtare të BE-së (Spanja, Greqia, Qiproja, Rumania dhe Sllovakia), Komisioni Evropian

i ka duart e lidhura, megjithatë me dyer të mbyllura, Knausi tha se është duke u vepruar për të gjetur zgjidhje.

Ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, theksoi se mosnjohja e Kosovës nga pesë vendet e BE-së vazhdon të mbetet problematike. Megjithatë, ai e përmendi faktin se pasaportat e Kosovës i kanë njohur të gjitha vendet e BE-së. Pajaziti tha se në kohën e nxjerrjes së pasaportave të Kosovës nuk ka qenë e mundur teknikisht të lëshoheshin pasaportat biometrike.

Përveç pasaportave biometrike, ka edhe kritere të tjera që duhen plotësuar në gjithë këtë proces. "Ajo çfarë na duhet është që të kemi një partneritet me vendet e BE-së, të nënshkruajmë marrëveshje të riatdhesimit, të ndalet migrimi ilegal dhe të hapet rrugë e re e migrimit legal", tha ministri. Ai u shpreh se jozyrtarisht thuhet se pas studimit të fizibilitetit për Kosovën, një ndër rekomandimet e Komisionit Evropian mund të jetë përfshirja e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave dhe nëse ndodh kjo, sipas tij, do të jetë

tejet inkurajuese.

Ambasadorja e Çekisë në Kosovë, Janina Hrebickova, vendi i së cilës është kryesuese e BE-së, tha se rajoni në të cilin përfshihet edhe Kosova ka perspektivë evropiane. Ambasadorja çeke tha se i mirëpret reformat e Qeverisë së Kosovës në fushën e demokracisë, barazisë dhe sidomos mbrojtjes së pakicave. Sipas saj, përmbushja e kriterëve për liberalizimin e vizave varet nga Qeveria e Kosovës, ndërsa nuk mohoi se, përveç kriterëve teknike për çështje të caktuara, mund të ketë edhe ndikime politike. "Edhe Çekisë tetë vjet i është dashur deri në përmbushjen e kriterëve për regjim pa viza, mirëpo në rastin e Kosovës duhen gjetur mënyra ndryshe nga marrëveshjet klasike për të mos e lënë anash procesit".

Në këtë debat u përsërit se, megjithëse pohohet se Kosova ka të ardhme evropiane, qytetarët e saj nuk mund të lëvizin lirshëm në vendet e BE-së. Përveç procedurave për viza dhe pavarësisht shpenzimeve që bëhen, shpeshherë nuk jepen as arsyet e mohimit të tyre.